

STATUTI

I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA **Print Art**

Ky Statut formulohet ne baze te Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"

Kreu I

Data e Themelimit , Emri i Shoqerise , Themaluesit /Ortaket , Objekti, Kohëzgjatja, Adresa/Selia

Neni 1 - Data e Themelimit dhe Emri i Shoqerise

Sot me date 06.02.2023 , ne **Ortaket SHERBET SPAHIU , DENIS PEZA dhe KLAJDI PJEÇI ,**
kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara me emrin **Print Art**
Shpk.

Neni 2 - Themeluesit dhe Ortaket e Shoqërisë :

1- SHERBET SPAHIU , i biri i Tasim dhe Naime , lindur me 05.09.1987 ne German-Kavaje dhe banues ne Rr. "Sabaudin Gabrani ,Nd 0.39,Tirane .Njesia bashkiake nr 6,1027 Tirane " , Godina nr 12. Identifikuar me numer pashaporte BC3227236 dhe numer personal I70905002O , madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar.

2 - DENIS PEZA , i biri i Ramiz dhe Bajame , lindur me 22.10.1982 ne Tirane dhe banues ne Rr. "Gryka e Pezakeve 03920115 nd 9 ,H1 ,Kashar ,Yrshek 1050 ,Tirane. Identifikuar me numer leternjoftimi 032039200 dhe numer personal I21022102G , madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar.

3 – KLAJDI PJEÇI , i biri i Aziz dhe Shpresa , lindur me 04.09.1992 ne Kryevidh,Kavaje dhe banues ne Rr. "Kristaq Prifti,Nd 8 ,H3,Ap 22,Kashar,Yzberisht,1050 ,Tirane. Identifikuar me numer pashaporte BA4826672 dhe numer personal J20904067S , madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar.

Neni 3 - Objekti:

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e me posht permendur:

Aktivitet ne fushen prodhimit dhe tregtimit te mobiljeve , cdo lloj operacioni dhe transaksioni me lidhje me importin,eksportin,prodhimin shperndarje dhe tregtim te produkteve te drurit dhe te ngjashme si me shumice dhe pakice,ne natyren e lendes se pare,produkteve gjysem te gateshme apo te gateshme,makinerive,paisjeve,pjeseve te ndertimit,teknologjive,perpunim dhe tregtim te lendes drusore. ambalazheve ne cdo forme.

Neni 4 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat : e papercaktuar

Neni 5 - Adresa/ Selia

Njesia administrative Kashar, Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia administrative Kashar**, Rr. "Gryka e Pezakeve 03920115 nd 9 ,H1 ,Kashar ,Yrshek 1050 ,Tirane.

(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: Ska

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: printa461@gmail.com

Kreu II - Kapitali

Neni 5 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120 000 Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. **Ortaku SHERBET SPAHIU** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40 000 leke , qe perben 33.33% te kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Ortaku KLAJDI PJEÇI** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40 000 leke , qe perben 33.33% te kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. **Ortaku DENIS PEZA** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40 000 leke , qe perben 33.33% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet , ne varesi te kontributeve në para apo në natyrë , vetem nepermjet vendimit te Asamblese. Shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 - Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të kesaj shoqërie dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar te shoqërisë janë të transferueshme ndërmjet ortakëve, pasi te jete nenshkjruau prej tyre ; Vendim I Asamblese dhe Kontrata perrpara Noterit. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III - ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 - Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administrator/it/ëve
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 - Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë (ose nëpërmjet komunikimit elektronik, në adresat e-mail ose whatsapp të secilit prej ortakëve). Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë: vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Në raste të vecanta, për arsye të justifikuara dhe pranuar nga të gjithë ortakët, Asambleja e përgjithshme mund të thirret edhe brenda ditës ose të nesërmen e njoftimit, dhe mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht kohës së njoftimit.

Neni 10 - Kuorumi

Në çdo rast e për çfarëdo lloj arsye, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 - Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të (se paku 51%) të votave të ortakëve, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorin/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 - Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 - Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është deri në 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit/ëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratori/ët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat prej 5 Vitesh:

Administrator i kësaj shoqërie do të jetë **Z. KLAJDI PJEÇI**, i biri i Aziz dhe Shpresa, lindur me 04.09.1992 në Kryevideh, Kavajë dhe banues në Rr. "Kristaq Prifti, Nd 8 ,H3, Ap 22, Kashar, Yzberisht, 1050 ,Tirane. Identifikuar me numer pashaporte BA4826672 dhe numer personal J20904067S, madhor e me zotesi të polote juridike për të vepruar.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit/ëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këto statut.
- f-Administratori/et është / janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë.
 - shoqëria, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë..
- Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- Shoqëria duhet të japë kredi dikujt.

g- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 - Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë ushtrimit të detyrave për administrimin e shoqërisë.

Administratori është i detyruar që të ver në dispozicion të Ortakëve (paraprakisht Draftin e mundshëm) dhe pas nenshkrimin , cdo Marrveshje apo Kontrate që nenshkruan , duke u dorëzuar atyre , kopje të marrveshjeve apo kontratave (ose të skanuara duke i dërguar ato në adresat e elektronikë të secilit Ortak) , jo më vonë se dy ditë nga data e nenshkrimin të marrveshjes ose kontratës. Marrveshje apo Kontrata të cilat do të nenshkruaj vetëm pas miratimit paraprakisht me shkrim nga asambleja e ortakëve. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit , pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ato të shoqërisë;
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori/et , gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hëtitimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, secili prej ortakëve individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV - Viti financiar-ekspertet

Neni 16 - Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 - Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollin periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V - Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18 - Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 - Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20 - Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21 - Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata qe e perfshin ne kompetencen e saj lendore dhe vendore.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Print Art

Z. SHERBET SPAHIU

SHERBET SPAHIU

Z. DENIS PEZA

Denis Peza

Z. KLAJDI PJEÇI

Klajdi Pjeci

Tirane me 06.02.2023